



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1024/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Klas Pek” D.O.O., me PIB:..., me seli në Merosina - Serbi, rruga “Cara Lazara”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura “Projusticia” në Prishtinë, kundër debitorit “Tava Group” Sh.p.k., me NUI:..., rruga “Dëshmorët e Kombit” nr.5, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat A. B. nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.664/21 të datës 03.06.2021 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 13.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Tava Group” Sh.p.k., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.664/21 të datës 03.06.2021 i Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Klas Pek” D.O.O., ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.664/21 të datës 03.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura nr.4/11 e datës 24.08.2020, ku e ka urdhëruar debitorin që brenda 7 ditëve pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit tërësisht borxhin sipas faturës në shumën prej 1,873.00 €, shumën e shpenzimeve të avokatit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.06/2014, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes të autorizuarit brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin pasi që fatura nuk është nënshkruar nga ana e debitorit si dhe malli i përshkruar në faturë është i pa qarkullueshëm pasi që paketimet e produkteve kanë qenë të shqyera si dhe ka munguar specifikimi i vëllimit për produkt. Tutje ka shtuar se ka kërkuar nga kreditori që të kthehet malli dhe të zëvendësohet me tjetër sipas marrëveshjes të cilën nuk e ka përfillur kreditori. Në vazhdim ka deklaruar se për të metat e mallit kreditorin e ka njoftuar përmes telefonit dhe përmes postes elektronike, andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj në tërësi prapësimin si të bazuar, shfuqizoj urdhrin përmbartimor si dhe të obligohet pala kreditore që ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditore në përgjigjen në prapësim përmes të autorizuarit, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, për arsye se kreditore e ka dorëzuar mallin siç ka qenë i përshkruar në faturë. Tutje ka shtuar se nuk është lajmëruar brenda afatit për të metat materiale brenda afatit ligjor sipas LMD-së. Fotot e bashkangjitura nuk dëshmojnë ditën e saktë kur janë vërejtur, andaj i ka propozuar Gjykatës ta hedh poshtë si të pa bazuar prapësimin si i pa bazuar si dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr.4/11 e datës 24.08.2020, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i*

tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se Fatura nr.4/11 e datës 24.08.2020 edhe pse janë pranuar nga debitori, të njëjtat janë kundërshtuar nga ana e debitorit përmes komunikimit të postës elektronike së datës 22.05.2021.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, pasi fatura është kundërshtuar pas pranimit të saj, nënkupton se debitori të njëjtën nuk e ka pranuar dhe nuk është pajtuar me përmbajtjen e saj dhe për këtë arsye gjykata vlerëson se faturat e pa nënshkuara dhe të kundërshtuara nga ana e debitorit, paraqesin dokumente të njëanshme dhe si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1024/22, datë 13.11.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.